

Mbështetur në nenin 28 paragrafi 3 të Ligjit Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit,
Ky dokument përbën:

AKTIN E THEMELIMIT DHE STATUTIN E

MUSABELLIU Brand sh.p.k

KAPITULLI I: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Emri dhe Forma Juridike

Shoqëria 'MUSABELLIU Brand sh.p.k' (në vijim Shoqëria) është një entitet Shqiptar me formën ligjore si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.p.k) dhe themeluar në datën 17.01.2025 me nje afat te pacaktuar kohor.

2. Selia ligjore

- Shoqëria ka vetëm një seli për kryerjen e aktivitetit:
rruga VATH KORESHI; Nd. 6; H. 1; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.2; 1010;
TIRANË.
- Shoqëria mund të hapë degë të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Kohëzgjatja

- Shoqëria themelohet ne date për një periudhe me afat të pa caktuar

4. Objekti i veprimtarisë

- Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:
Qepja dhe prodhimi i veshjeve, import export i produkteve, veshje dhe materialeve textile.
- Objekti i aktivitetit të Shoqërisë mund të zhvillohet brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.
- Shoqëria ka të drejtë të zgjerojë objektin e veprimtarisë së saj në cdo kohë me vendim të asamblesë së përgjithshme.

5. Ortakët

- Shoqëria përbëhet nga dy ortakë të cilet janë :
 - Personi fizik (sipas të Drejtës Civile) Megi Musabelliu me numër ID K25108050I, shtetase Shqiptare, lindur më 08.01.2002 në qytetin e Fierit, Shqipëri dhe banuese në Tiranë, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë 5000 Lek, që përbën 50% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
 - Personi fizik (sipas të Drejtës Civile) Kiara Musabelliu me numër ID K35716069I, shtetase Shqiptare, lindur më 16.07.2003 në qytetin e Fierit, Shqipëri dhe banuese në Tiranë, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë 5000 Lek, që përbën 50% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

KAPITULLI II: KAPITALI DHE KUOTAT

1. Kapitali i Shoqërisë

- Shuma e kapitalit themeltar të Shoqërisë është 10000 Lek, që përben 100% të kapitalit të shoqërisë, i ndarë në 2 kuota ku secila ka vlerën 5000 Lek, dhe do të dorëzohet nga ortakët e me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Të gjitha kontributet e ortakëve janë në para.
- Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve.
- Kontributet e shtuara mund të jenë në para ose në natyrë, duke emetuar kuota të reja apo duke rritur vlerën nominale të kuotave ekzistuese.

2. Transferimi i kuotave

- Kuotat mund të transferohen në rastet e shitblerjes dhe dhurimit. Ky transferim duhet të bëhet me kontratë të shkruar dhe të nënshkruar.
- Ortaket e shoqërisë nuk mund të shesin kuotat e tyre tek persona të tretë pa marrë si fillim miratimin e ortakëve të shoqërisë. Këta të fundit kanë të drejtën e parablerjes të njohur nga Kodi Civil.

- Kuotat mund te transferohen edhe nëpërmjet trashëgimisë.

KAPITULLI III: ADMINISTRIMI DHE PËRFAQËSIMI

1. Organet Drejtuese

- Asambleja e përgjithshme e ortakëve është organi kontrollues dhe vendimmarrës i Shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin e saj ekonomik dhe tregtar.
- Asambleja e përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet e njohura nga ligji në fuqi Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri.
- Shoqëria do të administrohet nga një administrator.
- Administratori i shoqërisë është Megi Musabelliu me numër ID K25108050I
- Afati i emërimit do të jetë 5 vite, duke filluar nga data 17.01.2025, e regjistrimit të këtij Statuti në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, deri ne daten 16.01.2030, me të drejtë ripërtëritjeje të papërcaktuar.
- Marrëdhënia e Administratorit me Shoqërinë ndërtohet mbi baza mirëbesimi. Heqja e postit të tij mund të bëhet me vendim të asamblesë së përgjithshme bazuar mbi arsyet e ligjit Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare në fuqi.

2. Kompetencat e Administratorit

- Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të dakortësuara dhe të vendosura në asamblen e përgjithshme.
- Administratori është përfaqësues i Shoqërisë.
- Mban përgjegjesi për kujdesin dhe mbajtjen e rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë.
- Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet dhe shpërndarjen e fitimeve. Këto dokumente i paraqet përpara asamblesë së përgjithshme për miratim.
- Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë sipas ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

- I raporton asamblesë së përgjithshme informacionet e nevojshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e Shoqërisë tregtare.
- Bën thirrjen e asamblesë së përgjithshme me njoftim nëpërmjet postës elektronike 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme.
- Administratori do të jetë individualisht përgjegjës ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Cdo pasoje që vjen nga marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja e përgjithshme që i sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut i cili ka bërë marrëveshjen, për tu përballur mes tyre në mënyrë individuale ose solidarisht, sipas rastit.

3. Asambleja e Përgjithshme

- Përgjegjës për marrjen e vendimeve për Shoqërinë në çështjet e cituara në nenin 81, pika 1 të ligjit nr. 9901 Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.
- Asambleja mbledhet dy herë në vit detyrimisht dhe sa herë është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë.
- Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave për cdo vendim të çështjeve të shtruara.
- Për ortakët të cilët nuk janë të pranishëm njihet e drejta e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike që mundësojnë identifikimin e qartë të tyre.
- Ortakëve ju njihet e drejta e marrjes së vendimeve unanime në cdo vendim me kusht që të jetë me shkrim.
- Secili ortak mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme nga një i tretë në bazë të një autorizimi ose nga një ortak tjetër.
- Cdo kuotë jep secilit prej ortakëve të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme si dhe të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë .

4. Administrimi Financiar

- Asambleja e përgjithshme cakton një ekspert kontabel të autorizuar sipas legjislacionit Shqiptar.
- Viti ekonomik financiar fillon në ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon në ditën e 31 të muajit Dhjetor të secilit vit.

KAPITULLI IV: TË DREJTAT DHE DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA KUOTAT

1. Shpërndarja e Fitimeve

- Fitimi u shpërndahet ortakëve në mënyrë të barabartë pavarësisht kuotave të zotëruara.

2. Përballimi i humbjeve

- Ortakët përgjigjen në mënyrë solidare për humbjet që i shkaktohen Shoqërisë.

KAPITULLI V: DISPOZITA TË TJERA

1. Mbyllja e Shoqërisë

- Shoqëria mbyllet me vendim të asamblesë së përgjithshme ose me hapjen e procedurave të falimentit

2. Aplikimi i ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare

- Për cdo çështje e cila nuk gjen zbatim në këtë statut, Shoqëria i referohet ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

KAPITULLI VI: DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Hyrja në Fuqi

- Ky akt themelimi i cili perben edhe statutin e shoqerise, hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të gjithë ortakët.

Ortakët

Megi Musabelliu

Kiara Musabelliu

MUSABELLIU Brand sh.p.k